



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 485/2 Prot

Tiranë, më 21.07.2020

V E N D I M

Nr.73, datë 21.07.2020

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 485, datë 2.6.2020, të nëpunëses ***, në lidhje me pretendimet për parregulsi në formularin e përshkrimit të punës”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të përcjellë nga kërkesa e nëpunëses *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpunësja ***** ka ngritur pretendimin se, formulari i përshkrimit të punës për pozicionin “*Specialist finance*”, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, për të cilin ajo ka konkurruar, ndryshon në disa pika nga formulari i përshkrimit të punës, i cili i është vënë në dispozicion për tu firmosur, pas emërimit të saj, në këtë pozicion.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se, punonjësja ***** është nëpunëse civile në periudhë prove në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Financave*”, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, e emëruar me aktin nr. 718 prot., datë 4.2.2020, të Departamentit të Administratës Publike dhe me Urdhrin nr.206/3, datë 3.3.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili ka dalë në zbatim të aktit të emërimit nga DAP.

Pas emërimit të saj në këtë pozicion, Përgjegjësi i Sektorit të Financës, në cilësinë e zyrtarit mbikëqyrës për këtë punonjëse, i ka vënë në dispozicion formularin e përshkrimit të punës, për tu njohur me punën konkrete që do të kryejë, detyrat dhe përgjegjësitë që do të ketë gjatë ushtrimit të funksionit, si dhe për ta nënshkruar atë. Pas njohjes me këtë formular, punonjësja në fjalë, ka refuzuar nënshkrimin e tij, duke pretenduar se, ai ndryshon në disa pika nga formulari që i është vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të institucionit, duke krijuar në këtë rast, një situatë mosmarrëveshjeje në ambientet e punës.

Në vijim të hetimit administrativ të këtij rasti rezulton se, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, brenda strukturës të së cilës, përfshihen dhe Drejtoritë Vendore të Policisë, është institucion varësie i Ministrisë së Brendshme, i cili, me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, u përfshi në fushën e shërbimit civil (VKM nr.142, datë 12.3.2014, lidhja nr. 1, numër rendor 87). Në këto kushte, Departamenti i Administratës Publike, sipas përcaktimeve në nenin 4, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, paraqitet si *njësi përgjegjëse* në administrimin e shërbimit civil të institucionit, ndërsa Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në bazë të nenit 10, të ligjit, është njësi përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, përfshirë këtu, në rastin konkret, edhe Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.

Konstatohet se, momenti i fundit që ka diktuar nevojën e hartimit të përshkrimeve të punës në këtë institucion, ka qenë ndryshimi i strukturës, të miratuar me Urdhrin nr.328/1, datë 2.5.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës në nivel vendor, në Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar (shkresa e DAP nr.2043/1, datë 22.5.2020, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë).

Në këtë kuadër, konstatohet se, formulari i përshkrimit të punës për pozicionin *“Specialist finance”*, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, i përgjigjet kërkesave ligjore për hartimin e tij, të përcaktuara me hollësi në Vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr.1, datë 31.5.2017, të DAP, *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*. Ky formular, është miratuar dhe nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, si dhe nga drejtuesi i institucionit të policisë vendore Lezhë, në cilësinë e eprorit direkt, në zbatim të pikës 18, shkronja “c”, të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, i ndryshuar, si dhe të pikës 4.2.10, të Udhëzimit të mësipërm të DAP.

Gjithashtu konstatohet se, qëllimi i përgjithshëm i punës dhe detyrat kryesore në këtë formular, janë sipas lidhjes 3/1, të parashikuara në pikën 12/1, të Kreut III, të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, i ndryshuar, ku përcaktohet përshkrimi i përgjithshëm dhe kërkesat minimale, për grupet e pozicioneve, ndër të tjera edhe për pozicionin *“Specialist finance”*. Ky formular i është vënë në dispozicion nëpunëses nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të institucionit,

për tu njohur me punën që do të kryejë, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë që do të ketë gjatë ushtrimit të funksionit të saj.

Ndërkohë, nga verifikimi i mëtejshëm, rezulton se, formulari i përshkrimit të punës, që i është vënë në dispozicion punonjësës në fjalë nga eprori i saj (në linjën e hierarkisë), në të gjitha ndarjet, është i njejtë, ndërsa përsa i përket ndarjes IV, “Detyrat kryesore”, ai është më i detajuar, ku secila nga detyrat kryesore (*formulari i miratuar përmban 6 detyra kryesore*), është zbërthyer, duke treguar specifikisht se çfarë pune do të kryhet për përmbushjen e detyrave.

Duke patur parasysh se, përshkrimi i punës shërben *së pari*, për të njohur nëpunësin civil me detyrat e me punën që duhet të kryejë dhe *së dyti*, për vlerësimin e rezultateve në punë, pasi, të gjithë elementët që ai përmbledh, ndikojnë për të kontrolluar dhe për të vlerësuar performancën e punonjësit, zbërthimi i detyrave kryesore që përmban formulari i miratuar në këtë rast, nga zyrtari raportues (në bazë të pikës 2/b, Kreu I, të VKM nr.109, datë 26.2.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, Përgjegjësi i Sektorit të Financës, paraqitet në cilësinë e “Zyrtarit raportues” për pozicionin “Specialist finance”), duke i bërë ato më të matshme, i shërben pikërisht përmbushjes dhe realizimit të këtyre detyrave, si dhe marrjes së një vendimi sa më objektiv në lidhje me periudhën e provës, në kushtet kur kjo nëpunëse është në periudhë prove. Në këtë kuptim, specifikimi i detyrave për të konkretizuar veprimtarinë e punonjësit në shërbim të mbarëvajtjes së punës dhe të marrëdhënies në punë epror-vartës, nuk mund të konsiderohet si parregullsi dhe të shërbejë si shkak i arsyeshem për refuzimin e nënshkrimit të formularit të përshkrimit të punës nga nëpunësja *****.

Nga sa është parashtruar më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe fakteve të çështjes konkrete, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundimin se, pretendimi i nëpunësës ***** , për parregullsi në formularin e përshkrimit të punës, është i padrejtë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 485 prot., datë 2.6.2020, të nëpunëses *****, në lidhje me pretendimet për parregullsi në formularin e përshkimit të punës për pozicionin “*Specialist finance*”, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
2. Të njoftohet për këtë vendim nëpunësja *****, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha